



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.060/01-8863/26
Kaçanik, 23.04.2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **IV (katërt)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e 8 e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 23.04.2026, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të administratës komunale, në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Selajdin Troni, Lejla Muhaxheri-Çaka, Bashkim Krasniqi, Kadrije Lika Troni, Ernesta Krasniqi, Ardita Rrahmani, Kjani Zeneli.

Nga Ekzekutivi i Komunës: Nënkryetari i Komunës- Xhelal Dema, Drejtorët e Drejtorive: Valdrin Dogani-DBF, Korab Krasniqi-DUKMM, Arlinda Rakoci-Raka-DZHET, Suhad Dullovi- DBPZHE. Nga zyrtarët: Asistentja e Kryesuesit, Zyrtarja për Marrëdhënie me publikun -Kabineti i Kryetarit, Zyrtarja për punë të KK.

Mbledhjen e kryesoj, Selajdin Troni, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit- Selajdin Troni, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, prezentë janë 7 anëtarët-të gjithë, materialin e keni marrë, e hapi mbledhjen e IV (katërt) të rregullt të KPF-së për vitin 2026, data 23.04.2026, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;
3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A.- Kaçanik;
4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin:

znj. Kadrije Lika Troni: Kërkoj shtimin e një pike në rendin e ditës për mbështetje financiare të familjeve me fëmijë me autizëm. Në këtë drejtim, propozoj formimin e një komisioni që do ta adresojë në kuvend propozimin për subvencionimin e këtyre kategorive të fëmijëve. Familjet që kujdesen për fëmijë me autizëm përballen me kosto të larta për terapi, trajtime dhe kujdes të vazhdueshëm. Një mbështetje financiare simbolike

prej 50€ në muaj do të ndihmonte në lehtësimin e kësaj barre, ndërsa me rishikimin e buxhetit kërkoj që kjo shumë të rritet.

znj. Ardita Rrahmani: Propozimi është i qëlluar, por ka edhe kategori tjera të cilat duhet të përfshihen, që mos të ndihen të diskriminuara. Kjo çështje nuk mundet me u përgatitur shpejtë, kështu që për mbledhjen vijuese mundet me u formua një grup punues, i cili do të punoj në bashkëpunim me HANDIKOS, DSHMS për identifikimin e saktë të këtyre kategorive të fëmijëve.

znj. Kadrije Lika Troni: Të dhënat për fëmijët autik i ka drejtorja e Arsimit.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse ekziston një regjistër, ai regjistër mund të mos jetë i saktë. Ka shumë familje në Kaçanik që nuk i kanë të lajmëruara rastet. Kjo çështje kërkon debat publik, me i inkurajuar qytetarët me ardhur me i regjistruar ata fëmijë, pastaj komuna me i subvencionuar. Unë jam për me u subvencionuar, por fillimisht me u bërë identifikimi i saktë i tyre nga një komision, se nuk besoj që DSHMS që i ka numrat e saktë të tyre.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë e dhashë një propozim që të adresohet në KK, në KK e diskutojmë. Ne mundemi me shtuar edhe kategori tjera, por si kategori me e prekur, autizimi kërkon një mbështetje specifike. Në bashkëpunim me DSHMS ne mundemi me formuar një komision me vazhduar me punuar në këtë drejtim, se është e nevojshme ti japim mbështetje kategorive të fëmijëve me nevoja të veçanta, sidomos fëmijëve me autizëm.

znj. Ernesta Krasniqi: E mbështes propozimin e Kadrijes për subvencionimin e fëmijëve me autizëm. Numri i fëmijëve me autizëm është në rritje dhe ekzistojnë forma të ndryshme të autizmit, si autizmi mediatik etj. Prandaj, konsideroj se duhet të përfshihen sa më shumë kategori në skemën e subvencionimit. Megjithatë, aktualisht mungojnë të dhëna të sakta lidhur me numrin real të këtyre fëmijëve. Para 5-6 vitesh kam punuar në shkollën e Elezajt me fëmijë me nevoja të veçanta, ku numri i tyre ka qenë relativisht i vogël. Besoj se sot ky numër është dukshëm më i madh. Për këtë arsye, është e nevojshme që drejtoritë përkatëse të angazhohen më shumë në hulumtimin dhe identifikimin e rasteve në terren, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë reale e tyre. Këta fëmijë kanë nevojë për mbështetje institucionale, socializim dhe trajtim të vazhdueshëm, ndërsa familjet e tyre përballen me shpenzime të konsiderueshme. Subvencionimi i tyre është një ndihmë shumë e rëndësishme. Edhe pse për momentin shuma e paraparë mund të konsiderohet simbolike, me rishikimin e buxhetit do të ishte e arsyeshme që kjo shumë të rritet në të ardhmen.

z. Bashkim Krasniqi: Propozimi për me i mbështetur fëmijët me autizëm, është i qëlluar, mendoj se duhet kohë deri me procedimin e kësaj çështje në KK, se numri i tyre nuk besoj që është i saktë. Duhet drejtorive kompetente me iu dhënë kohë me identifikuar numrin e saktë të tyre, që mos të mbetet asnjë fëmijë autik pa u përfshirë në listë. Komuna duhet me shikuar edhe mundësitë buxhetore me i subvencionuar, sa me tepër që ka mundësi buxhetore, aq me mirë është.

Kryesuesi i Kuvendit: Besoj se duhet me pasur edhe dokument mjekësor këta kategori të fëmijëve.

z. Valdrin Dogani: Në parim është një propozim interesant dhe jemi për me mbështetur këta kategorive të fëmijëve, por duhet një analizë pak me e thellë, me e mirëfilltë, me ditur numrin dhe koston buxhetore. Buxheti i vitit 2026 i ka orientimet e përcaktuara se ku kanë me u shpenzuar. Mendoj se paraprakisht duhet me i bërë do matje me të mëdha.

Përveç kësaj, ne përmes DA e subvencionojmë transportin e fëmijëve me autizëm që shkolljnë në shkollë, në bazë të kërkesave që i paraqesin në drejtori.

znj. Ernesta Krasniqi: Ku i keni futur në buxhetin e vitit 2026 shtesat për lehonat, a kanë qenë të planifikuara me buxhet?

z. Valdrin Dogani: Shtesat për lehonat kanë qenë të planifikuara në buxhet të kategorisë së subvencioneve dhe transfereve. Në vitin 2025 i kemi pasur subvencionet diku 514 mijë euro. Në vitin 2026, janë planifikuar 614 mijë euro, ku janë paraparë mjete për nënat lehonat. Kur ka ardhur vendimi në KK, ka qenë e paraparë një shumë e përafërt për lindjet, duke u bazuar në Agjencinë e statistikave të Kosovës për lindjet në Kaçanik nëpër vite.

z. Kjani Zeneli: Në parim e mbështeti kërkesën që e ngriti LVV. Mendoj se DSHMS dhe DA i kanë statistikën për numrin e autikëve. Për me identifikuar numrin saktë të tyre dhe buxhetin, mendoj se në KK mund të formohet grupi punues me punuar në këtë drejtim, ndërkaq si kërkesë e mbështetimit me përcjellë në KK.

znj. Ardita Rrahmani: Kur të propozohet një pikë, ne duhet me pasur materialin, që të shqyrtojmë në KK a e miratojmë apo jo. Në parim jam me mbështetur, por duhet me pasur material. Nëse është çështja vetëm me diskutuar, atëherë mund të ngritet në KK të pyetjet dhe kërkesat. Ndërsa, nëse vjen si pikë për shqyrtim dhe aprovim, mendoj se duhet me pasur paraprakisht materialin.

znj. Kadrije Lika Troni: Ne e jepem një propozim, ndërkaq në KK drejtoresha na vjen me shifra të sakta. Në momentin që bëhet një rishikim buxhetor, të hynë për ekzekutim subvencionimi i këtyre kategorive të fëmijëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë propozoj që se pari të bëjmë një komision, të bisedojmë edhe me drejtoreshën e DSHMS, se nuk mundemi kaq shpejt me vendosur këtë çështje, se duhet të identifikohen të gjitha rastet, që mos të ngelë asnjë rast pa hyrë në listën e subvencionimit.

znj. Ardita Rrahmani: Nëse hynë si pikë e rendit të ditës në KK, duhet të pajisemi me material, se ne nuk mundemi me votuar diçka pa i pasur të dhënat dhe koston financiare.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne mundemi me bërë pikë të rendit të ditës në KK me diskutuar, por jo me votuar, se është kohë e shkurtër. Për sot unë nuk pajtohem me ia kaluar KK, pa i pasur të dhënat për numrin e autikëve, se mund të ketë raste që nuk janë lajmëruar, ndërkaq nëse dëgjojnë se po subvencionohen, u japim kurajë për me i lajmëruar rastet. Mundeni me kërkuar në KK të jetë pikë e rendit të ditës, ashtu që DSHMS me përgatitur lëndën brenda një muaji, ndërkaq DBF me kalkulua koston financiare.

znj. Ardita Rrahmani: Edhe unë jam për me diskutuar në KK, por jo me vendosur në këtë mbledhje.

Ernesta Krasniqi: Nuk është në përgjegjësitë tona që ne me iu ofruar material, është në kompetencë të drejtorive përkatëse se ata i kanë të dhënat, se për një anëtar të KK është vështirë me përgatitur materialin. Nuk besoj se është vonë me u përgatitur lënda, neve në KK na vijnë lëndë aty për aty për me i votuar.

znj. Ardita Rrahmani: Është në përgjegjësi të propozuesit me bërë materialin.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo çështje është me e ndieshme Ernesta.

znj. Ernesta Krasniqi: E kuptoj që lënda është me i ndieshme, për atë ne po e diskutojmë në mbledhje të KK, pastaj i jepet kohë drejtorive një muaj kohë me përgatitur lëndën.

znj. Ardita Rrahmani: Ju Kadrije keni propozuar dy vite me parë me fol për barazinë gjinore dhe për dhunën në familje 16 ditë aktivizëm. Ju e keni përgatitur pikën, për të cilën është hapur diskutimi në KK.

znj. Kadrije Lika Troni: Unë për diskutim në KK kam material pse duhet me i subvencionuar fëmijët autikë, ndërkaq KK vendosë se a është propozim i duhur me mbështetur këta kategori të fëmijëve.

z. Valdrin Dogani: Buxheti i ka orientimet e tij, kështu që pa rishikim të buxhetit nuk mundet me u realizuar subvencionimi.

Nënkryetari i Komunës: Xhelal Dema: Krejt jemi me mbështetur subvencionimin e këtyre kategorive të fëmijëve, por buxheti i vitit 2026 i ka orientimet e tij, kështu që mundet me planifikuar subvencionimi i këtyre fëmijëve me buxhetin e vitit 2027.

znj. Arlinda Rakoci-Raka: Ka prind që nuk i paraqesin rastet, DHMS dhe DA nuk munden me i pasur të dhënat e sakta. Të arsim jam e bindur se ka me shumë raste, se në shkollë mundet me vërejtur mësuesi, ndërkaq prindi nuk e paraqet në QPS rastin. Për atë mundet me pasur mospërputhje të shifrave. Nëse nuk jam gabim, numri është diku 200 fëmijë.

znj. Ardita Rrahmani: Për atë duhet bashkërendim i drejtorive përkatëse për me përgatitur lëndën për KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë lidhur me këtë çështje, kërkoj nga LVV të adresoni çështjen në DSHMS, në mënyrë që drejtoria në bashkërendim me drejtoritë tjera përkatëse të përgatit lëndën dhe t'ia adresoj KK.

znj. Kadrije Lika Troni: Në rregull, atëherë kërkesën për subvencionim të fëmijëve me autizëm ia adresojmë DSHMS, e cila drejtori në bashkërendim me drejtoritë tjera përkatëse të përgatit lëndën dhe t'ia adresoj KK.

Kryesuesi i Kuvendit: Rendin e punës, e shtroj në votim për aprovim pa kërkesën e LVV dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Konstatohet se KPF

APROVOJ

Rendin e punës prej 4 pikave- të përcaktuara si në ftesën për mbledhje.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Procesverbalit i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Prezentë 7. Konstatohet se KPF

APROVOJ

2.Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bashkim Krasniqi: Nëse i shikojmë realizimin e këtij buxheti, del se për TMI janë realizuar diku 25.9% apo ¼ e buxhetit është shpenzuar. Mendoj se raporti është korrekt, i mirë, transparent, nuk kam asnjë vërejtje në këtë raport financiar.

znj. Kadrije Lika Troni: Nga raporti shihet se ekzekutimi i investime kapitale është vetëm 14%, krahasuar me vitin 2025 shihet se kanë shënuar rënie në këtë program shpenzues buxhetor. Pyetje: Pse projektet infrastrukturore nuk kanë filluar me kohë dhe cilat janë masat që do të merren për shpejtimin e realizimit të këtyre mjeteve? Shërbimet komunale shihet se janë dyfishuar, nga 37 mijë në 72 mijë euro, apo një rritje prej 92% Cili është arsyeja për këtë rritje të kostove operative? Subvencionet dhe transferet, shënojnë rritje prej 48.7%, raporti nuk sqaron qartë se kush ka përfituar, cilat kanë qenë kriteret për përfituesit, dhe a ka pasur transparencë për ndarjen e tyre. Të HVK, realizimi i tyre është vetëm 18. 7% e planit vjetor. Pyetje për drejtorin: Cilat masa konkrete po merren për rritjen e inkasimit sidomos të tatimi në pronë dhe taksat komunale? Sa e di unë edhe me staf jeni mangët, nuk ka shef -menaxher të zyrtarëve të tatimit në pronë. A po merren masa dhe a keni bërë ndonjë riorganizim të stafit të kjo zyre?

z. Valdrin Dogani: Për pyetjet e ngritura lidhur me investimet kapitale, realizimi i tyre ka filluar me vonesë për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndarjet Buxhetore, i cili është votuar më 2 mars. Deri në fund të marsit, institucioni ka funksionuar me 1/12 e buxhetit, gjë që ka pamundësuar shpenzimin e mjeteve kapitale. Gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar vetëm shpenzimet rrjedhëse, si mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere. Si pasojë e vonesës në miratimin e ligjit, nuk ka qenë e mundur të bëhen zotime për investime kapitale, të iniciohen procedura apo të paguhen obligime të bartura nga viti 2025, pasi mjetet kapitale nuk kanë qenë në dispozicion. Sa i përket shpenzimeve komunale, janë dhënë sqarime të detajuara për secilën kategori. Ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve përfshihet përfundimi i sistemit të ngrohjes dhe klimatizimit në objektin e administratës, ku ngrohja me dru është zëvendësuar me energji elektrike. Gjithashtu, zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në lagje të ndryshme ka krijuar kosto shtesë, të cilat mbulohen nga DSHPE. Në kategorinë e subvencioneve përfshihen mbështetjet për entitete jopublike, kryesisht OJQ-të, të cilat financohen përmes DKRS në bazë të thirrjeve publike dhe kriterëve të përcaktuara. Sivjet, thirrja publike është hapur më herët dhe shumica e OJQ-ve janë subvencionuar në kohë. Po ashtu, në këtë kategori përfshihen edhe shpenzimet e varrimit, të realizuara në bazë të marrëveshjes me BI-në, si dhe mbështetja për qytetarët me vështirësi ekonomike apo shëndetësore. Përfitimet jepen pas shqyrtimit të kërkesave dhe verifikimit nga komisioni përkatës. Nga transferet janë mbuluar edhe pagesat për nënat lehona dhe përfitues të tjerë individualë. Lidhur me tatimin në pronë, gjatë kësaj jave është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e udhëheqësit të tatimit në pronë. Gjithashtu, në KPF dhe KK është dhënë zotimi për ndërmarrjen e hapave konkretë drejt rianketimit të pronave, përmes angazhimit të një kompanie profesionale dhe zhvillimit të një fushate vetëdijesimi me qëllim të rritjes së inkasimit të tatimit në pronë.

Nënkryetari i Komunës-Xhelal Dema: Edhe faturimi është bërë me vonesë, është shtyrë afati i pagesës ende pa u bërë faturat.

z. Valdrin Dogani: Faleminderit Nënkryetar se harrova me potencuar se edhe faturimi është bërë me vonesë, është shtyrë afati i pagesës ende pa u bërë faturat. Te të HVK e kam cekur se me 1 prill ka filluar me u shtypur faturat e tatimit në pronë për ngarkesat e vitit tatimor 2026. Ka pasur të interesuar me paguar, por pa u bërë faturat, nuk ka pasur mundësi, për shkak se faturimi është i ndikuar prej Ligjit për Ndarjet Buxhetore. Pas shtypjes se faturave të tatimit në pronë, besoj se ka me pasur ngritje të inkasimit të tatimi në pronë në TM2 dhe në TM3.

z. Kjani Zeneli: Shumë mirë e shpjegoj drejtori se është shtyrë afati i pagesës ende pa u bërë faturimi. Shpërndarja e faturave bëhet të ne.

znj. Ernesta Krasniqi: Me vet faktin që është shtyrë afati i pagesës, ende pa u bërë faturimi, të tregon se ka pasur vonesa në faturim.

znj. Kadrije Lika Troni: Të përmbledhja e ekzekutimit të buxhetit, të participimet, është një shumë 160.85€. A po vazhdohet përsëri me participimet, siç ka ndodhur të DBPZHR?

z. Valdrin Dogani: Participimet janë sikurse fondi burimor i të HVK që bartët çdo vit. Këto participime nëse nuk shpenzohen, bartën nga viti në vit. Kjo është nga viti 2015, nëse nuk gaboj. E mbaj mend participimin e rrugës në lagjen Leka, mjetet që kanë participuar banorët janë bartur, ndërkaq projekti veç është kryer me herët.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë me shkuar në KK. Njëzëri ishin Për. Prezentë 6. Konstatohet se KPF, **Diskutoj Raporti tremujor financiar për periudhën: Janar-Mars 2026 dhe të njëjtin ia përcellë Kuvendit të Komunës në procedurë të shqyrtimit.**

3. Propozim Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A.- Kaçanik;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

znj. Ernesta Krasniqi: A është kjo çështje e njëjtë sikurse propozimi i anëtarëve të KK për komisionin KRM "Pastërtia"? Unë në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e këtij komisioni, ndërkaq ka qenë e definuar se një anëtar i takon subjektit me të madh opozitar, ndërkaq këtë herë janë veç 3 anëtarë, kryesuesi i komisionit dhe dy anëtarë.

Arian Teneqja: Stacioni i Autobusëve është ndërmarrje publike komunale, trajtohet me Ligjin e njëjtë për ndërmarrjet publike, sikurse ndërmarrje publike KRM "Pastërtia". Një (1) anëtar e propozon kryetari i komunës, dy (2) anëtarë emërohen në KK me shumicë të thjeshtë të votave. Procedura është e njëjtë, trajtohen me ligjin e njëjtë, për arsye se të dyja janë ndërmarrje publike.

znj. Kadrije Lika Troni: Drejtor a mundesh me na shpjeguar me në detale se cili është roli i këtyre anëtarëve në ndërmarrjen publike?

z. Arian Teneqja: Vet titulli tregon rolin e komisionit, përfaqësojnë interesat e komunës në ndërmarrje dhe kontrollojnë. Këta marrin pjesë në Bordin e drejtorëve dhe organizimi i Stacionit të autobusëve varet prej tyre se janë organ mbikëqyrës.

znj. Kadrije Lika Troni: Mendoj se pa qenë opozita pjesë e komisionit, si në mandatin e kaluar, mbikëqyrës nuk ka me kryer punën si duhet, se po anoni vetëm nga njëri subjekt të jetë i përfaqësuar. Unë mendoj se për me mbikëqyrën punën si duhet dhe me punuar si duhet, duhet me qenë edhe një anëtar nga opozita i përfaqësuar.

z. Arian Teneqja: Komuna menaxhohet nga pozita dhe jo nga opozita, kështu që komuna – subjekti që është në pozitë vendosë se kënd e donë me përfaqësuar në atë komision. Kjo nuk ka të bëjë me partitë politike, kjo ka të bëjë me pozitat, Kryetari i komunës, përkatësisht udhëheqja komunale vendosë se kënd e emëron në atë komision për me përfaqësuar ndërmarrjen komunale.

znj. Kadrije Lika Troni: Nëse vendosë Ekzekutivi dhe Kryetari i Komunës, atëherë kjo çështje nuk ka nevojë me ardhur në KK. Roli mbikëqyrës nuk ushtrohet nëse nuk ka përfaqësues të opozitës.

znj. Ernesta Krasniqi: Edhe unë mendoj se kjo çështje nuk ka nevojë me ardhur në KK, nëse vendosë Ekzekutivi dhe Kryetari i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit: Në Kuvend dërgohet Propozim Vendimi, sepse për dy (2) anëtarë vendosë KK.

z. Arian Teneqja: Është debatuar shumë edhe për komisioni e KRM “Pastërtia”, por i njëjti është kthyer pozitiv nga ministria e linjës.

znj. Ernesta Krasniqi: Ne e dimë që komuna udhëhiqet nga pozita, një anëtar caktohet nga kryetari. Ndërkaq për dy anëtarët tjerë, nëse ju mendoni se përcaktohet siç thoni ju pozita, në KK vendimi votohet nga pozita dhe opozita. Duhet t’ia qartësoni vetës se nuk mundeni me vendosur ju vetëm pse jeni pozitë.

z. Bashkim Krasniqi: Unë nuk e di çka nuk ka të qartë këtu, një anëtar e cakton Kryetari, dy anëtarë i cakton KK. Ju mundeni me dhënë propozimet e juaja, ndërkaq ai që i merr votat, emërohet në atë komision. Ju keni qenë në atë komision, por nuk mundeni me paragjykuar se nëse nuk përfaqësohet opozita, nuk ka me u mbikëqyrë kompania, se edhe ne ia duam të mirën këtij vendi.

znj. Ernesta Krasniqi: Nëse nuk përfaqësohet opozita, unë e kam një pikëpyetje për mënyrën e funksionimit të tij.

Kryesuesi i Kuvendit: Ju qysh po thoni, është mirë edhe në nivel qendror me qenë të përzier, për një funksionim me të mirë, se kontrolli bëhet me e mirë.

znj. Ardita Rahmani: Në parim kanë të drejtë që po thotë Ernesta, por duhet të ketë parasysh se kjo atëherë ka standard të dyfishtë.

znj. Kadrije Lika Troni: Duke u nisur nga mandati i kaluar që propozimet kanë ardhur nga subjekti pozitë dhe opozitë, pse kësaj here po veprohet ndryshe. Ju po doni me pasur kontrollin mbi këto komisione.

Kryesuesi i Kuvendit: Është diskutuar shumë për KRM "Pastërtia", por vlerësimi i ministrisë ka thënë se është në rregull vendimi i KK- është vlerësuar pozitivisht. Edhe ky vendim ka me shkuar në MAPL dhe ata e vlerësojnë se a është në rregull.

znj. Ernesta Krasniqi: Në mandatin e kaluar, një anëtar ka qenë nga PDK një anëtar, një anëtar ka qenë nga opozita.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë kemi gabuar.

znj. Ardita Rahmani: A paguhet ky komision?

Kryesuesi i Kuvendit: Jo nuk paguhet.

znj. Kadrije Lika Troni: A është kthyer vlerësimi i ligjshmërisë nga ministria e ekonomisë për vendimin e KRM "Pastërtia"

Kryesuesi i Kuvendit: Është kthyer pozitiv. Sa e di unë edhe juve ju kanë kthyer përgjigjen.

z. Korab Krasniqi: Është kthyer pozitiv vlerësimi i ligjshmërisë për atë vendim, ndërkaq janë kthyer negativ ankesat e juve që i keni pasur. Ai vendim është publikuar dhe është bërë i plotfuqishëm.

znj. Kadrije Lika Troni: Prej ministrisë së ekonomisë nuk me është kthyer, ndërkaq nga MAPL, po.

z. Arian Teneqja: Vlerësimi i ligjshmërisë për atë vendim ka qenë në rregull, vendimi është publikuar dhe ka hyrë në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit: Ligjshmëria është kthyer pozitiv dhe vendimi ka hyrë në fuqi. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë, me propozimin që për KK me u ndarë kjo pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 6. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimin për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për NPK "Stacioni i Autobusave" SH.A.- Kaçanik.

I rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

4. Propozim Vendim për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Korab Krasniqi: Në mbledhje të KK shpalljen me interes të kësaj prone keni me pa edhe përmes ekranit. Kërkesa është e kompanisë KIVO, për këmbim të një pjese të pronës së vet. Rruga që është në mes e paraqitur në skemë, e ka krijuar vet kjo kompani dhe e ka bërë rrugë publike, për qasje në pronën e vet, tani për shkak të nevojave të saj për zgjerim, janë dy parcela 2287-0 dhe 2310-0 që kërkon me i bashkuar, ndërkaq rrugën me zhvendosur në anën e djathtë.

znj. Ernesta Krasniqi: Kërkoj me ditur se ku gjenden ato prona. A është rruga kah pjesa prapa biznesit aktual të KIVO ku është ndërtuar një depo.?

z. Korab Krasniqi: Sqaroj pronat e KIVO se ku gjinden dhe theksoj se kjo rrugë momentalisht nuk ka dalje. Me bashkimin e dy pronave, i krijohet mundësi KIVO për me ndërtuar një fabrikë tjetër në atë pjesë. Rruga është të pjesa ku është ndërtuar një depo. Ato rrugë tani lidhen në mes veti, ky kërkon me i bërë bashkë parcelat, me hequr rrugën nga mesi dhe me zhvendosur poshtë, që me i dhënë qasje parcelës së tij. Në rrugën aktuale, vetëm parcela poshtë ka qasje, tani ne e heqim rrugën nga aty dhe ia krijomë qasjen parcelës së tij, krejt parcelës poshtë me qasje me të gjatë. Ne pasi kemi mundësi me i krijuar qasje, pa u dëmtuar askush, po ia mundësojmë KIVO këtë rrugën me e zhvendosur poshtë, ndërkaq KIVO me i bashkuar parcelat.

znj. Kadrije Lika Troni: Edhe raporti i m2 i pronës, shihet se me tepër jep KIVO sesa merr, është në favor të komunës.

z. Korab Krasniqi: Po, ne gjithmonë e ndjekim si praktikë me qenë të barabarta pronat që këmbehen, ose me shumë me marrë komuna sesa me dhënë.

znj. Ernesta Krasniqi: Në mbledhjen vijuese kam me kërkuar ndriçimin publik për atë rrugë.

z. Korab Krasniqi: E kemi në plan, por fillimisht do të bëjmë zgjerimin e saj, shtrimin me zhavorr, ndërkaq në vitin vijues me asfaltim. Ju mundeni me kërkuar, por kjo është e planifikuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë, me propozimin që për KK me u ndarë kjo pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 6. Konstatohet se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimin për Shpallje me interes publik të Parcelave Kadastrale në ZK Kaçanik i Vjetër.

I rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe Aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:00. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 06 anëtarë, me herët shkoj Lejla Muhaxheri-Çaka.

Mbledhja e IV (katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës e vitit 2026 e legjislaturës së 8, do të mbahet me 30.04.2026 (e enjte) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit
Selajdin Troni